

17 dhjetor 2025,
Prishtinë

Komisioni i Garave të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), në bazë të kompetencave të dhëna me aktet normative të FBK-së, nën suaza të mandatit që ushtron, në mbledhjen e mbajtur me datë 16.12.2025, në përbërje prej: Armend Hamiti kryetar i KG, Arianit Shala anëtar i KG dhe Ismet Ferati anëtar i KG shqyrtoi dhe miratoi këtë:

VENDIM NR.15/ 2025-26 I KOMISIONIT TË GARAVE

- I. Komisioni i Garave ka shqyrtuar kërkesën e paraqitur nga KBF United Basketball për regjistrimin e lojtares Dea Pushkolli si lojtar i lirë ("free agent")¹ jashtë afatit kalimtar.
- II. Pas shqyrtimit të kësaj kërkeje dhe në bazë të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, Komisioni i Garave REFUZON kërkesën e KBF United Basketball për lejimin e regjistrimit të lojtares Dea Pushkolli.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga data e publikimit.

¹ **Lojtar i lirë (free agent)** – lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.

ARSYETIM

Gjatë vendimmarrjes lidhur me dispozitivin e Vendimit Nr.15/2025-26, Komisioni i Garave ka marrë parasysh faktet në vijim:

- (a) Klubi KBF United Basketball ka paraqitë kërkesë për regjistrimin e lojtarit Dea Pushkolli si lojtar **të lirë (free agent) jashtë afatit kalimtar.**
- (b) Komisioni i garave vëren se me Vendimi 09/2025-26 KBF United Basketball ka shfrytëzuar te drejtën për lojtar të lirë dhe duke qenë se nuk plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregulloren për Regjistrim dhe Kalim të FBK-së për sezonin 2025/2026, Komisioni i Garave refuzon regjistrimin e lojtarit Dea Pushkolli për klubin KBF United Basketball.
- (c) Komisioni i Garave udhëzon që e njëjta lojtare mund të regjistrohet për KBF United Basketball me te drejte loje pas afatit kalimtar dimëror .

Komisioni i Garave:


Arianit Shala

Anëtar



Armend Hamiti

Kryetar



Ismet Ferati

Anëtar

Federata e Basketbollit të Kosovës

KËSHILLË JURIDIKE: Në pajtim me Nenin 45 të Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore, Edicioni 2025/2026, në vendimin e Komisionit të Garave është e lejuar ankesa tek Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (si organ i shkallës së dytë), e cila dorëzohet më së voni 24 orë pas marrjes së vendimit. Për ankesë, paraqitësi i ankesës duhet të deponojë në llogarinë e FBK-së shumën prej 500.00 €.